



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr. 02/L-45**

**PËR DIZAJNIN INDUSTRIAL**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 Maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Kreu 5.1. (ç), 9.1.1 dhe 9.1.26 (a), si dhe me qëllim të rregullimit të kushteve të mbrojtjes të dizajnit industrial dhe në harmoni me standardet e Bashkësisë Evropiane,

Miraton:

**LIGJIN PËR DIZAJNIN INDUSTRIAL**

**KREU I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë Ligj rregullohen kushtet e mbrojtjes të dizajnit industrial; e drejta e mbrojtjes, fitimi, vëllimi dhe vlefshmëria e mbrojtjes, të drejtat ekskluzive, procedurat për regjistrim, ndryshimet në dizajnin industrial, ndërprerja e vlefshmërisë dhe anulimi i dizajnit industrial, depozitimi ndërkombëtar i dizajnit, mbrojtja juridiko-civile dhe dispozita kundërvajtëse.

**KUPTIMI I TERMAVE DHE DEFINICIONET**

**Neni 2**

**Dizajn** - nënkupton formën e jashtme të produktit në tërësi apo të një pjese të produktit i cili rrjedhë nga karakteristikat e produktit, veçanërisht nga forma trajta, ngjyra, teksti dhe materiali i vet produktit.

**Produkt** - nënkupton çdo lëndë industriale apo artizanale duke përfshirë pos tjerash pjesët e dedikuara për harmonizim në tërësinë e produktit kompleks, paketimi, librat, simbolet grafike dhe format tipografike të shkronjave, por duke përjashtuar programet kompjuterike.

**Produkti kompleks** - nënkupton produktin i cili është i përbërë prej më shumë pjesëve të cilat mundë të ndërrohen ashtu që është e mundur ndarja dhe bashkimi i serishëm të produktit.

## KREU II KUSHTET PËR MBROJTJE

### Neni 3

3.1. Me dizajn industrial mbrohet dizajni në atë masë në të cilën është risi dhe i cili ka karakter të veçantë.

3.2. Dizajni i cili është zbatuar në produkt apo është pjesë përbërëse e produktit i cili është pjesë përbërëse e produktit kompleks konsiderohet risi dhe me karakter të veçantë vetëm: nëse pjesa përbërëse, pasi është i vendosur në produktin kompleks, mbetet i dukshëm gjatë përdorimit normal të produktit, nëse në masën në të cilën kjo dukshmëri karakteristike e pjesës përbërëse pavarësisht i plotëson kushtet e risisë, veçantisë dhe individualitetit.

3.3. Përdorimi normal në kuptimin e paragrafit 2 të këtij neni do të thotë përdorim nga ana e përdoruesit të produktit e cila nuk përfshinë mirëmbajtjen, servisimin dhe riparimin e produktit.

## RISIA E DIZAJNIT

### Neni 4

4.1. Dizajni i produktit konsiderohet risi nëse nuk është identik me dizajnin e vënë në dispozicion të publikut para datës së aplikimit për regjistrimin e dizajnit industrial (në tekstin e mëtutjeshëm): aplikacioni për dizajn industrial, gjegjësisht nëse është kërkuar e drejta e përparësisë, para datës së njohjes së përparësisë.

4.2. Dizajnet konsiderohen identike nëse karakteristikat e tyre ndryshojnë vetëm në imtësira të pa rëndësishme.

## KARAKTERI I VEÇANTË I DIZAJNIT

### Neni 5

5.1. Konsiderohet se dizajni ka karakter të veçantë nëse përshtypja që e lë tek konsumatori ndryshon nga përshtypja që në atë konsumator lë çfarëdo dizajni tjetër që ka qenë në dispozicion të publikut para datës së paraqitjes së aplikacionit për dizajn industrial apo nëse është kërkuar e drejta e përparësisë, para datës së pranimit të drejtës së përparësisë.

5.2. Gjatë vlerësimit të karakterit të veçantë të dizajnit duhet të merret parasysh shkalla e lirisë së krijimit të dizajnit nga ana e dizajnerit.

## PARAQITJA PUBLIKE E DIZAJNIT

### Neni 6

6.1. Konsiderohet se dizajni ka qenë i paraqitur për publikun nëse është publikuar me procedurën e regjistrimit apo në mënyrë tjetër i ekspozuar apo përdorur në tregti apo është bërë i njohur në mënyra tjera. Nuk konsiderohet se dizajni ka qenë i njohur për publikun edhe nëse nën kushtet e mësheftësisë, është njoftuar personi i tretë.

6.2. Risia e dizajnit nuk do të merret parasysh nëse dizajni për të cilin kërkohet mbrojtja ka qenë i paraqitur publikut: nga ana e dizajnesit, nga ana e trashëgimtarit të tij juridik apo personit të tretë, si rezultat i të dhënave të dhëna apo aktiviteteve të ndërmarra nga ana e dizajnesit apo nga ana e trashëgimtarit të tij juridik, gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së paraqitjes së aplikacionit të dizajnit industrial, apo nëse është kërkuar e drejta e përparësisë, para datës të të drejtës së pranuar të përparësisë.

6.3. Dispozitat nga paragrafi 2 të këtij neni do të zbatohen edhe në rastet kur dizajni është bërë publik si pasojë e keqpërdorimit në dëm të dizajnesit apo të trashëgimtarit të tij.

## DIZAJNI I KUSHTËZUAR ME FUNKSION TEKNIK DHE DIZAJNI I ELEMENTEVE TË PËRBASHKËTA

### Neni 7

7.1. Me dizajn industrial nuk mund të mbrohen karakteristikat e formës së produktit:

- a. të cilat janë të kushtëzuara me funksione teknike,
- b. për të cilat është i nevojshëm riprodhimi në formën dhe dimensionin e njëjtë në mënyrë që produkti në përbërjen e të cilit është dizajni do të mund që në mënyrë mekanike të bashkohet me produktin tjetër mund të vendoset në apo bashkë me produktin tjetër apo rreth tij, në mënyrë që të dy produktet të mund të kryejnë funksionet e veta.

7.2. Pavarësisht nga dispozitat nga paragrafi 1. pika b. të këtij neni, dizajni industrial do të ekzistojë, në përputhje me kushtet e cekura në nenin 4. dhe 5. të këtij Ligji, në dizajnin dedikimi i së cilit do të mundësojë lidhjen e pjesëve të ndërrueshme të një produkti.

## DIZAJNI KUNDËR INTERESIT PUBLIK APO KUNDËR PARIMEVE MORALE

### Neni 8

Nuk mbrohet dizajni i cili është në kundërshtim me interesin publik dhe parimet morale.

## ARSYET PËR REFUZIMIN E MBROJTJES APO ARSYET PËR PAVLEFSHMËRINË JURIDIKE

### Neni 9

Do të refuzohet kërkesa për regjistrimin e dizajnit, gjegjësisht dizajni industrial i regjistruar do të jetë juridikisht i pavlefshëm nëse:

- a. dizajni nuk është dizajn në kuptim të nenit 2 të këtij Ligji,
- b. dizajni nuk i përmbush kushtet e cekura në nenet 3. deri 8. të këtij Ligji,
- c. paraqitësi i aplikacionit apo bartësi i dizajnit industrial nuk është i autorizuar për fitimin e dizajnit industrial sipas këtij Ligji,
- d. dizajni është në kundërshtim me dizajnin e mëhershëm i cili ka qenë i publikuar pas datës së paraqitjes së aplikacionit të dizajnit industrial apo nëse është kërkuar e drejta e përparësisë, pas datës së pranuar të drejtës së përparësisë dhe i cili nga data

e mëhershme është mbrojtur me regjistrimin e dizajnit industrial në Kosovë apo me vetë aplikacionin të dizajnit industrial,

- e. gjatë krijimit të dizajnit është përdorë shenja dalluese, ndërsa bartësi i të drejtës së mëhershme ka patur të drejtën të ndaloj përdorimin,
- f. dizajni konsiderohet përdorim i pa autorizuar i veprës e cila është e mbrojtur në bazë të dispozitave të ligjit i cili rregullon lëmin e drejtës së autorit,
- g. dizajni përdoret në kundërshtim me cilido element të nenit 6 dhe Konventës së Parisit për mbrojtjen e Pronësisë Industriale, si dhe nëse përdoret në kundërshtim me shenjat apo stemat (që nuk janë parapa në Konventën e Parisit) e të cilat janë me interes të veçantë për Kosovën.

### KREU III E DREJTA PËR MBROJTJE

#### DIZAJNUESI

##### Neni 10

10.1. Dizajnues është personi fizik ose personi juridik, e që e ka krijuar dizajnin.

10.2. Personi i cili gjatë krijimit të dizajnit ka ofruar vetëm ndihmë teknike nuk konsiderohet dizajnues.

##### Neni 11

11.1. Pavarësisht se a është paraqitës i aplikacionit apo bartës i të drejtës, dizajnuesi ka të drejtë të çeket si dizajnues në të gjitha dokumentet gjatë ekspozimit publik të dizajnit të tij.

11.2. E drejta morale e dizajnuesit nuk mund të bartet.

11.3. Nëse disa dizajnues kanë marrë pjesë në krijimin e dizajnit e drejta nga paragrafi 1. i këtij neni i takon të gjithë dizajnuesve, pavarësisht kontributit në krijimin e dizajnit.

#### AUTORIZUESIT PËR FITIMIN E TË DREJTËS PËR DIZAJN INDUSTRIAL

##### Neni 12

12.1. Dizajnuesi apo trashëgimtari i tij juridik janë të autorizuar për fillimin e procedurës dhe fitimit të dizajnit industrial në përputhje me këtë Ligj.

12.2. Nëse dizajnuesi nuk është edhe paraqitës i aplikacionit të dizajnit industrial paraqitësi i aplikacionit do të konsiderohet i autorizuar në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni deri sa të mos dëshmohet e kundërta.

12.3. Nëse dizajni është krijuar në bazë të kontratës me porosi, porositësi i dizajnit të tillë është i autorizuar për fillimin e procedurës dhe fitimin e dizajnit industrial nëse me kontratë nuk është paraparë ndryshe.

12.4. Nëse dizajnin e ka krijuar dizajnuesi gjatë kryerjes së obligimeve si i punësuar apo duke i zbatuar këshillat e punëdhënësit, punëdhënësi është i autorizuar për fillimin e procedurës dhe fitimin e dizajnit industrial, nëse me kontratë nuk është e paraparë ndryshe.

12.5. Nëse dizajni është krijuar me punën e përbashkët të më tepër dizajnesve, të gjithë dizajnesve gjeqjesisht trashëgimtarëve të tyre juridik i takon e drejta e përbashkët në atë dizajn, dhe se të gjithë konsiderohen të autorizuar në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.

12.6. Pjesëmarrja dhe kontributi i dizajnesve në dizajnin e krijuar nga disa dizajnes caktohet varësisht nga kontributi real i secilit nga disajnesit nëse me kontratë nuk është paraparë ndryshe.

12.7. Nëse pjesëmarrja dhe kontributi i dizajnesve nuk janë të përcaktuar apo nuk mund të përcaktohen në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni konsiderohen të gjithë si të barabartë.

## BARAZIA E PERSONAVE TË CILËT MUND TË JENË BARTËS TË DIZAJNIT INDUSTRIAL

### Neni 13

Personat e huaj fizik dhe juridik të cilët nuk kanë selinë në Kosovë gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji nëse kjo rezulton nga kontratat që e obligojnë Kosovën ose nga zbatimi i parimeve të reciprocitetit.

## KREU IV FITIMI, VËLLIMI DHE VLEFSHMËRIA E MBROJTJES SË DIZAJNIT INDUSTRIAL

### FITIMI I DIZAJNIT INDUSTRIAL

#### Neni 14

14.1. Dizajni industrial fitohet me nxjerrjen e vendimit mbi regjistrimin e dizajnit industrial dhe regjistrimin në regjistër.

14.2. Data e regjistrimit në regjistër është data e nxjerrjes të vendimit mbi regjistrimin e dizajnit industrial.

### VËLLIMI I MBROJTJES

#### Neni 15

15.1. Mbrojtja e cila rrjedh nga dizajni industrial përfshinë çdo dizajn i cili tek konsumatori nuk len ndonjë përshtypje tjetër.

15.2. Gjatë vlerësimit të vëllimit të mbrojtjes do të merret parasysh shkalla e lirisë të cilën e ka patur dizajnesi gjatë krijimit të dizajnit.

### KOHËZGJATJA E MBROJTJES

#### Neni 16

16.1. Mbrojtja e dizajnit industrial zgjatë pesë vjet, duke llogaritur nga data e paraqitjes së aplikacionit të dizajnit industrial.

16.2. Mbrojtja e dizajnit industrial mundet që të zgjatet në periudhën prej 5 vjetësh , e më së tepërmi për periudhën prej njëzet e pesë vitesh duke llogaritur nga data e paraqitjes së aplikacionit.

16.3. Bartësi i dizajnit industrial i cili kërkon vazhdimin e mbrojtjes duhet që gjatë vitit të fundit të vlefshmërisë apo më së voni gjashtë muaj pas kalimit të periudhës së vlefshmërisë, ti paraqet Zyrës kërkesën për vazhdimin e mbrojtjes të dizajnit industrial dhe të paguan taksën dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës së mirëmbajtjes.

16.4. Periudha e re e mbrojtjes fillon me datën e kalimit të afatit të periudhës së mëparshme të mbrojtjes.

16.5. Regjistrimin e zgjatjes së mbrojtjes së dizajnit industrial publikohen në buletin zyrtar të Zyrës.

16.6. Të dhënat të cilat duhet ti përmban kërkesa për zgjatjen e mbrojtjes së dizajnit industrial rregullohet me aktet tjera nënligjore në zbatim të këtij Ligji.

## KREU V TË DREJTAT EKSKLUZIVE TË CILAT RRJEDHIN NGA DIZAJNI INDUSTRIAL TË DREJTAT EKSKLUZIVE

### Neni 17

17.1. Bartësi i dizajnit industrial ka të drejtën ekskluzive për shfrytëzimin e dizajnit të regjistruar dhe pengimin e personave të tjerë në përdorimin e dizajnit pa lejen e tij.

17.2. Përdorimi, në kuptimin e paragrafit 1. të këtij neni, përfshinë përpunimin, ofertën, vënien në qarkullim, importin, eksportin apo përdorimin e produktit në përbërjen e të cilit është dizajni.

17.3. Nëse publikimi i dizajnit industrial të regjistruar është shtyre në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, gjatë kësaj kohe deri sa vlen shtyrja, bartësi ka të drejtë të pengoj personat e tret në përdorimin e dizajnit vetëm nëse ky përdorim është rezultat i kopjimit të dizajnit të regjistruar.

## KUFIZIMI I DREJTAVE EKSKLUZIVE NGA DIZAJNI INDUSTRIAL

### Neni 18

18.1. Të drejtat ekskluzive nga neni 17 të këtij Ligji nuk mund të realizohen në raport me:

- a. veprimet e përdorimit të ndërmarra për qëllime private dhe jo komerciale
- b. veprimet e ndërmarra me qëllim të realizimit të ekzaminimit apo
- c. veprimet e reproduktimit të ndërmarra me qëllim të citimit apo edukimit, nëse kjo është në përputhje me rregullat e mirësjelljes në afarizëm dhe nuk shkakton dëm gjatë përdorimit normal të dizajnit.

18.2. Me veprimet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni të drejtat ekskluzive që dalin nga dizajni industrial pas regjistrimit nuk mund të realizohen lidhur me:

- a. pajisjet e fluturakeve të regjistruara në shtet tjetër, kur ato përkohësisht hyjnë në territorin e Kosovës,

- b. importin e pjesëve rezervë, në Kosovë, me qëllim të riparimit të fluturakeve,
- c. realizimin e riparimeve të fluturakeve.

## PËRDORIMI I MËHERSHËM

### Neni 19

19.1. Të drejtën e përdorimit të mëhershëm e ka çdo i treti person i cili mund të argumentoj se para datës së paraqitjes së aplikacionit të dizajnit industrial apo para datës së njohjes së përparësisë, nëse është kërkuar në territorin e Kosovës, ka filluar përdorimin e dizajnit apo ka kryer përgatitje paraprake me qëllim të përdorimit edhe nëse dizajni i tillë nuk është krijuar me kopjimin e dizajnit të mbrojtur më parë.

19.2. Në bazë të së drejtës të përdorimit të mëhershëm, personi i tretë është i autorizuar ta përdor dizajnin për qëllime të përdorje para datës së paraqitjes të aplikacionit për dizajn industrial apo para datës së drejtës së pranuar të përparësisë, nëse përparësia është kërkuar.

19.3. Personi i cili ka të drejtë në drejtën e përdorimit të mëparshëm nuk mundet personave tjerë të jep licencë për përdorimi e dizajnit.

19.4. E drejta e përdorimit të mëhershëm nuk mund të bartet, përheq kur personi i tretë është ndërmarrës bashkë me bartjen e ndërvarësisë në kuadrin e së cilës janë ndërmarr veprime të përdorimit apo të zbatimit, në përputhje të paragrafi 1. të këtij neni.

## MBARIMI I SË DREJTËS

### Neni 20

20.1. Mbarimi i të drejtës në ndalimin e përdorimit të produktit i cili përmban dizajn mbaron me vënien e saj në tregun e Kosovës nga ana e vet bartësit të dizajnit industrial apo pas lejimit nga ana e bartësit.

20.2. Mbarimi i të drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zgjerohet edhe për territorin jashtë Kosovës, nëse një gjë e tillë është e përcaktor me kontratat ndërkombëtare që e obligojnë Kosovën.

## KREU VI

### RAPORTI NDAJ FORMAVE TJERA TË MBROJTJES

#### ZBATIMI I LIGJEVE TJERA

### Neni 21

Dispozitat e këtij Ligji nuk ndikojnë në zbatimin e rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me markat tregtare, patente si dhe rregullat të cilat përcaktojnë përgjegjësitë civile - juridike apo konkurrencën jo lojale në treg.

### RAPORTI NDAJ TË DREJTËS SË AUTORIT

### Neni 22

Dizajni i cili është i mbrojtur me dizajn industrial mund të jetë i përshtatshëm edhe për mbrojtje me dispozitat të drejtës së autorit nga momenti i krijimit apo fiksimit të saj në

çfarëdo forme, natyrisht nëse i plotëson kushtet e ligjeve të caktuara nga lëmi i së drejtës së autorit.

## KREU VII PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN E DIZAJNIT INDUSTRIAL

### AUTORIZIMI I ZYRËS

#### Neni 23

23.1. Për kryerjen e punëve administrative që kanë të bëjnë me mbrojtjen e dizajnit industrial, kompetente është Zyra për patentim e themeluar me Ligjin për patentim nr 2004/49.

23.2. Kundër vendimeve të Zyrës, lejohet ankesë në afatë prej 15 ditëve, në organin e shkallës së dytë në Zyrën për Patentim.

23.3. Kundër vendimit të shkallës së dytë, mund të iniciohet kontest administrativ, te gjykata kompetente sipas Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative.

### INICIMI I PROCEDURËS PËR REGJISTRIMIN E DIZAJN INDUSTRIAL

#### Neni 24

Procedura për njohjen e dizajnit industrial iniciohet me dorëzimin e dokumentacionit Zyrës e që duhet të përmbaj kërkesën për njohjen e dizajnit industrial.

### PËRMBAJTJA E APLIKACIONIT PËR DIZAJN INDUSTRIAL

#### Neni 25

25.1. Aplikacioni i dizajnit industrial duhet të përmbajë:

- a. kërkesën për regjistrimin e dizajnit industrial,
- b. të dhënat mbi paraqitësin e aplikacionit,
- c. paraqitjen e dizajnit e cila duhet të jetë e përshtatshme për reproduktim. Nëse lënda e aplikacionit është dizajn dy dimenzional, ndërsa nëse aplikacioni përmban kërkesën për shtyrjen e publikimit në përputhje me nenin 36 të ligjit, paraqitja e dizajnit mund të bëhet me mostër.

25.2. Aplikacioni i dizajnit industrial duhet të përmbaj edhe:

- a. shenjën e produktit në të cilën zbatohet dizajni,
- b. të dhënat mbi përfaqësuesin e autorizuar me autorizimin nëse paraqitësi i aplikacionit e posedon,
- c. nëse është paraqitur aplikacioni i përbashkët, të dhënat mbi përfaqësuesin e përbashkët.

25.3. Aplikacioni i dizajnit industrial mund të përmbaj:

- a. përshkrimin me të cilën shpjegohet paraqitja apo mostra e dizajnit,
- b. kërkesën për shtyrjen e publikimit të dizajnit industrial të regjistruar në përputhje me nenin 36. të këtij ligji,
- c. klasifikimin e produktit gjegjësisht shënimin e klasës në të cilin dizajni duhet të jetë pjesë përbërëse apo në të cilin dizajni do të duhet zbatuar, në përputhje me marrëveshjen e Lokarnës, (duke u bazuar në: Klasifikimin Ndërkombëtar),



- d. të dhënat mbi dizajnesin apo dizajnesit apo shënimi se dizajnesi apo dizajnesit nuk dëshirojnë të ceken,
- e. të dhënat mbi dëshmitë mbi përparësinë nga neni 29 dhe 30 të këtij Ligji.

25.4. Me më akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji më hollësisht përshkruhen të gjitha pjesët përbërëse të aplikacionit për dizajn industrial.

25.5. Të dhënat të cilat janë në aplikacion për dizajn industrial e që janë të cekura në paragrafin 2. pika a. dhe paragrafi 3. pika a. dhe c. të këtij neni nuk ndikojnë në vëllimin e mbrojtjes së dizajnit.

## APLIKACIONI I SHUMËFISHTË I DIZAJNIT INDUSTRIAL

### Neni 26

26.1. Nëse aplikacioni i dizajnit industrial përmban kërkesë për regjistrimin e më tepër dizajnëve (në tekstin e mëtutjeshëm aplikacioni i shumëfishtë), të gjitha produktet në të cilat dizajni është pjesë përbërëse, apo në të cilat dizajni do të duhej të zbatohet duhet të lidhen me produktet e radhitura në një klasë në bazë të klasifikimit ndërkombëtar.

26.2. Në aplikacionin e shumëfishtë duhet të shënohet numri i përgjithshëm i dizajnëve për të cilat kërkohet mbrojtja.

26.3. Ndaj çdo dizajni që është përfshirë në aplikacionin e shumëfishtë, mund të veprohet ndaras, me qëllim të zbatimit të dispozitave të këtij Ligji. Dizajni në rastet e tilla mund të jetë lëndë e realizimit të drejtave si nga kontrata mbi licencat, hipotekës apo pengut, falimentimit, bartjes së drejtave, shtyrjes së publikimit apo shpalljes nulë.

## NDARJA E APLIKACIONIT TË SHUMËFISHTË

### Neni 27

27.1. Paraqitësi i aplikacionit mund të ndajë aplikacionin e shumëfishtë në dy apo më tepër aplikacione ashtu që çdo njëra mund të bëjë me një të një të cilat më tepër dizajnë të produktit.

27.2. Aplikacioni i cili krijohet me ndarjen nga aplikacioni i shumëfishtë e mban të drejtën e përparësisë të atij aplikacioni.

27.3. Kushtet e tjera për ndarjen e aplikacionit të shumëfishtë rregullohen me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji.

## PËRPARËSIA

### Neni 28

Paraqitësi i aplikacionit të dizajnit industrial me date të mëparshme të paraqitjes ka të drejtën e përparësisë lidhur me çdo paraqitës tjetër i cili e bën paraqitjen më vonë për dizajnin e njëjtë.

### Neni 29

29.1. Nëse aplikuesi për dizajnin industrial ka bërë paraqitjen për herë të parë në ndonjë vend anëtar të Unionit ndërkombëtar të themeluar me konventën e Parisit për mbrojtjen e pronës industriale (në tekstin e mëtutjeshëm: Unioni i Parisit), me rastin e aplikimit për të

njëtin dizajn industrial në Kosovë, mund të thirret në datën e aplikimit të parë, me kusht që aplikimin në Kosovë ta bëjë brenda afatit gjashtë muaj nga kjo datë.

29.2. Aplikuesi që thirret në të drejtën e përparësisë lidhur me paragrafin 1. të këtij neni, në paraqitjen e tij në Zyrë duhet të deponoj të dhënat themelore mbi aplikimin në të cilin thirret (shteti, data dhe numri i aplikimit), dhe atë më së voni brenda afatit tre muaj nga data e aplikimit në Zyrë duke prezantuar përshkrimin e aplikimit të parë të vërtetuar nga organi i autorizuar i shtetit anëtar të Unionit të Parisit si dhe përkthimin e përshkrimit në gjuhën zyrtare që aplikohet në Kosovë.

29.3. Nëse paraqitësi i aplikacionit nuk i përmbush kushtet e cekura nga paragrafi 1. i këtij neni, konsiderohet se përparësia nuk është kërkuar.

## E DREJTA E PËRPARËSISË SË EKSPOZIMIT

### Neni 30

30.1. Nëse aplikuesi ka bërë ekspozimin e produktit që përbën dizajn industrial në ndonjë ekspozitë zyrtare ose në ndonjë ekspozitë ndërkombëtare zyrtarisht të pranuar në Kosovë ose në ndonjë shtet anëtar të Unionit të Parisit, mund të kërkoj që si datë e aplikacionit të parë ti pranohet data e parë e ekspozimit të produktit, me kusht që paraqitjen në Kosovë ta bëjë brenda afatit 6 muaj nga data e cekur.

30.2. Aplikuesi i cili thirret në të drejtën e përparësisë mbi bazën e ekspozimit të produktit është i detyruar që krahas paraqitjes në Zyrë të deponojë edhe vërtetimin e lëshuar nga ana e organit të autorizuar të shtetit anëtar të Unionit të Parisit në të cilin vërtetohen të dhënat mbi llojin e ekspozitës, vendin e mbajtjes së ekspozitës, datën e hapjes dhe mbylljes dhe ditën e parë të ekspozimit të produktit të dhënë në aplikime, si dhe dëshmia mbi dizajnin e produktit të paraqitur në ekspozitë.

30.3. Nëse paraqitësi i aplikacionit nuk i përmbush kushtet e cekura ne paragrafi 2. të këtij neni konsiderohet se përparësia nuk është kërkuar.

## PËRCAKTIMI I DATËS SË PARAQITJES SË APLIKACIONIT TË DIZAJNIT INDUSTRIAL

### Neni 31

31.1. Pas pranimit të aplikacionit për dizajn Zyra shqyrton aplikacionin se a i përmbush kushtet për pranimin e datës së aplikimit nga neni 25. paragrafi 1. të këtij ligji.

31.2. Nëse aplikacioni nuk i plotëson kushtet për pranimin e datës së aplikimit Zyra fton aplikuesin që në afat prej 60 ditësh, nga dita e marrjes së ftesës, të plotësoj mungesat e përcaktuara.

31.3. Nëse paraqitësi i aplikacionit të dizajnit industrial në afatin e përcaktuar i plotëson mungesat e aplikacionit në përputhje me paragrafin 2. të këtij neni Zyra vërteton datën e pranimit të aplikacionit, pas plotësimit të mungesave si datë e paraqitjes së aplikacionit.

31.4. Nëse paraqitësi i aplikacionit të dizajnit industrial në afatin e përcaktuar nuk vepron në bazë të ftesës së zyrës, aplikacioni refuzohet.

31.5. Pas vërtetimit të datës së aplikimit Zyra fton paraqitësin i cili nuk ka paraqit dëshminë mbi pagesën e taksës administrative dhe kompensimin e shpenzimeve, që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të ftesës të ofroj dëshmi mbi pagesën e bërë.

31.6. Nëse paraqitësi i aplikacionit nuk vepron në bazë të ftesës nga paragrafi 5. i këtij neni aplikacioni refuzohet.

#### SHQYRTIMI FORMAL I APLIKACIONIT PËR DIZAJN INDUSTRIAL ME DATËN E VËRTETUAR TË APLIKIMIT

##### Neni 32

32.1. Me shqyrtim formal të aplikacionit për dizajn industrial, në rastin kur është paraqitur aplikacioni i shumëfishtë, Zyra vërteton se a i plotëson aplikacioni i paraqitur kushtet nga neni 25. paragrafi 2. të Ligjit, gjegjësisht kushteve nga neni 26. dhe 27 të këtij Ligji.

32.2. Nëse aplikacioni nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 1. të këtij neni Zyra e fton aplikuesin që në afat prej 60 ditësh, të plotësoj aplikacionin.

32.3. Me kërkesën e paraqitësit të aplikacionit të dizajnit industrial, afati nga paragrafi 2. i këtij neni mund të zgjatet më së tepërmi edhe për 60 ditë.

32.4. Nëse paraqitësi i aplikacionit për dizajn industrial nuk vepron në bazë të ftesës, aplikacioni me vendim refuzohet.

#### VENDIMI MBI REFUZIMIN PËR REGJISTRIMIN E DIZAJNIT INDUSTRIAL

##### Neni 33

33.1. Zyra me vendim, refuzon kërkesën për regjistrim të dizajnit industrial nëse: dizajni nuk plotëson njërin nga kushtet e parapara me nenin 2.(dizajni), nenit 8 dhe të nenit 9 paragrafi 1. pikat (a), (b).

33.2. Zyra mund të merr vendim për refuzim të pjesërishtëm për regjistrim të dizajnit industrial, për shkak të mos përmbushjes së njëres nga kërkesat e parapara me nenin 8 ; 9 paragrafi 1 pika (b), (c).

33.3. Vendimi për refuzim të kërkesës për regjistrim të dizajnit industrial nuk mund të merret para se ushtruesi i kërkesës të jetë njoftuar me shkrim për mos përmbushjen e kushteve të parapara e për të cilat duhet të deklarohet, apo të tërheq kërkesën.

33.4. Parashtruesi i kërkesës për regjistrim të dizajnit industrial ka të drejtë që në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim në bazë të paragrafit 3 të këtij neni, të sjell dëshmi mbi të dhënat e reja që do të mund të ndikonin në vendimin përfundimtar të Zyrës.

33.5. Në kërkesë të parashtruesit për regjistrim të dizajnit industrial, afati nga paragrafi 4. i këtij neni mund të zgjatet më së tepërmi edhe për 60 ditë.

#### VENDIMI MBI REGJISTRIMIN DIZAJNIT INDUSTRIAL

##### Neni 34

Nëse dizajni i produktit nuk është i përjashtuar nga mbrojtja në bazë të nenit 33 paragrafi 1 të këtij Ligji dhe nëse është bërë pagesa mbi kompensimin e procedurës së mirëmbajtjes për periudhën e parë pesë vjeçare për mbrojtje të dizajnit industrial Zyra do të merr vendim mbi regjistrimin e dizajnit industrial dhe dizajnin industrial do ta publikoj në Regjistër.

## PUBLIKIMI I DIZAJNIT INDUSTRIAL

### Neni 35

35.1. Të dhënat mbi dizajnin industrial publikohen ne buletin zyrtar të Zyrës më së voni tre muaj nga data e regjistrimit të dizajnit industrial në regjistër.

35.2. Përmbajtja e të dhënave të cilat publikohen në buletin zyrtar të zyrës rregullohen me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji.

## SHTYRJA E PUBLIKIMIT TË DIZAJNIT INDUSTRIAL

### Neni 36

36.1. Paraqitësi i aplikacionit për dizajnin industrial mundet njëkohësisht bashkë me aplikacion të parashtror edhe kërkesën për shtyrjen e publikimit të dizajnit industrial të regjistruar, për periudhën deri në 12 muaj duke llogaritur kohën nga data e paraqitjes së aplikacionit apo të kërkesës ndaj Zyrës, ndërsa nëse është kërkuar e drejta e përparësisë, nga data e përparësisë së pranuar.

36.2. Nëse është kërkuar shtyrja e publikimit të dizajnit industrial në buletin zyrtar të zyrës do të publikohet në mënyrën e paraparë me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji, vetëm fakti se dizajni industrial është i regjistruar.

36.3. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni Zyra pas skadimit të afatit të shtyre do të fton paraqitësin e aplikacionit apo bartësin e dizajnit industrial që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ftesës të paraqet fotot dhe paraqitjet grafike të dizajnit të aplikacionit, në përputhje me nenin 25. paragrafi 1. pika c. të këtij ligji.

36.4. Nëse bartësi i dizajnit industrial nuk i përmbush kërkesat nga paragrafi 3. të këtij neni apo nëse nuk ka paguar kompensimin e shpenzimeve të procedurës së mirëmbajtjes për periudhën e parë pesëvjeçare do të konsiderohet se dizajni industrial nuk ka prodhuar efekt juridike.

36.5. Nëse është fjala për dizajn industrial të shumëfishtë, paragrafi 1. dhe paragrafi 3. të këtij neni mund të zbatohen edhe në një të njërit nga disa dizajne që e përmban aplikacionin.

## DOKUMENTI MBI DIZAJNIN INDUSTRIAL

### Neni 37

37.1. Me kërkesë të bartësit të dizajnit industrial me kusht se është paguar kompensimi i shpenzimeve për lëshimin e dokumentit mbi dizajnin industrial, Zyra bartësit të dizajnit industrial i lëshon dokumentin më së voni tre muaj nga data e publikimit të dizajnit industrial në buletin zyrtar të Zyrës.

37.2. Përbërja e të dhënave të cilat i përmban dokumenti për dizajn industrial rregullohen me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji

KREU VIII  
NDRYSHIMET NË DIZAJNIN INDUSTRIAL  
REGJISTRIMI I NDRYSHIMEVE

Neni 38

38.1. Me kërkesën e aplikuesit ose pronarit të dizajnit industrial, Zyra regjistron në Regjistër të gjitha ndryshimet që kanë të bëjnë në ndryshimin e emrit ose vendbanimit nëse është fjala për personin fizik, ose ndryshimet për ndërmarrjen dhe selinë e personit juridik si dhe ndryshimet tjera që janë paraqitur pas aplikimit për dizajnin industrial ose pas regjistrimit të dizajnit industrial, me kusht që këto ndryshime t'i përgjigjen gjendjes faktike dhe të cilat nuk kanë ndikuar në esencën e dizajnit industrial.

38.2. Ndryshimet e regjistruara në Regjistër të dizajneve industriale publikohen në buletin zyrtar të Zyrës.

38.3. Të dhënat që duhet të përmbajë kërkesa për t'i regjistruar ndryshimet nga paragrafi 1. i këtij neni rregullohen me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji.

LICENCIMI

Neni 39

39.1. Dizajni industrial mund të jetë lëndë e licencimit në tërësi apo pjesërisht, ndërsa licenca mund të jepet për tërë apo për një pjesë të territorit të Kosovës.

39.2. E drejta në shfrytëzimin e dizajnit industrial fitohet në bazë të kontratës mbi licencimin kurse kjo e drejtë e ka efektin në personin e tretë pas regjistrimit të licencës në Regjistër. Regjistrimi i licencës bëhet me kërkesën e pronarit të dizajnit industrial.

39.3. Kontrata mbi licencimin duhet të jetë e formës së shkruar dhe e nënshkruar nga ana e palëve kontraktuese.

39.4. Bartësi i dizajnit industrial mund t'i realizojë të drejtat nga dizajni industrial ndaj fituesit të licencës i cili shkelë ndonjë depozitë nga kontrata mbi licencimin veçanërisht në lidhje me kohëzgjatjen e licencës dhe kufijtë e përdorimit të dizajnit industrial.

39.5. Fituesi i licencës mund të inicioj kontest gjyqësor në pikëpamje të shkeljes së të drejtave që dalin nga dizajni industrial vetëm nëse bartësi i dizajnit industrial me këtë pajtohet.

39.6. Fituesi i licencës është i autorizuar të jep nën licenca vetëm nëse kjo theksohet në kontratë.

39.7. Licenca ka veprim ndaj personave të tretë pasi që të regjistrohet në regjistër.

39.8. Regjistrimi i licencës publikohet në buletin zyrtar të Zyrës.

39.9. Regjistrimi i licencës behët me kërkesën e bartësit të dizajnit industrial ose të fituesit të licencës me kusht që zyrës i është parashtruar kopja e kontratës mbi licencën.

39.10. Të dhënat që duhet të përmban kërkesa për regjistrimin e licencës rregullohen me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji.

## PENGU DHE EKZEKUTIMI

### Neni 40

- 40.1. Dizajn industrial mund të jetë lëndë e pengut dhe lëndë e ekzekutimit.
- 40.2. Me kërkesën e njëres nga palët, e drejta nga paragrafi 1. të këtij neni regjistrohet në regjistër.
- 40.3. Regjistrimi i pengut dhe ekzekutimit publikohen në buletin zyrtar të Zyrës.
- 40.4. Pengu dhe ekzekutimit krijojnë pasoja juridike në personat e tjerë pas regjistrimit në regjistër.
- 40.5. Përmbajtja e të dhënave të cilat duhet ti përmbaj kërkesa për regjistrim të pengut, rregullohet me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji.

## FALIMENTIMI

### Neni 41

Kur dizajni industrial është lëndë e falimentimit, me kërkesë të organit kompetent kjo e dhënë regjistrohet dhe publikohet në buletin zyrtar të Zyrës.

## BARTJA E TË DREJTAVE

### Neni 42

- 42.1. Aplikuesi apo bartësi i dizajnit industrial mund ta bartë të drejtën e tij të aplikimit ose dizajnin industrial në tërësi ose pjesërisht në persona të tjerë.
- 42.2. Me kërkesën e njëres nga palët bartja e të drejtës regjistrohet në regjistër me kusht që Zyrës i është dorëzuar kopja e vërtetuar e kontratës mbi bartjen e të drejtës, i nënshkruar nga të dy palët.
- 42.3. Bartja e të drejtës ka veprim juridik ndaj personave juridik vetëm pas regjistrimit në regjistër.
- 42.4. Regjistrimi i bartjes publikohet në Buletinin Zyrtar të Zyrës.
- 42.5. Të dhënat që duhet ti përmbaj kërkesa për regjistrimin e bartjes së të drejtave rregullohet me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji

## KREU IX

### PËRFUNDIMI I VLEFSHMËRISË DHE ANULIMI I DIZAJNIT INDUSTRIAL PËRFUNDIMI I VLEFSHMËRISË SË DIZAJNIT INDUSTRIAL

### Neni 43

- 43.1. Dizajni industrial pushon të vlejë në rastet si në vijim:
  - a. nëse kalon afati i vlefshmërisë së dizajnit industrial në kuptim të nenit 16. këtij Ligji,
  - b. në bazë të deklaratës së bartësit për heqjen dorë prej dizajnit industrial, dizajni industrial nuk është i vlefshëm nga e data e dorëzimit të deklaratës për heqjen dorë në formë të shkruar e të dorëzuar në Zyrë. Nëse licencimi është i regjistruar në

regjistër heqja dorë nga dizajni industrial do të regjistrohet në regjistër vetëm nëse bartësi i dizajnit industrial dëshmon se fituesin e licencës e ka lajmërua për qëllimin e tij për heqjen dorë nga dizajni.

43.2. Ndërprerja e vlefshmërisë të dizajnit industrial regjistrohet në regjistrin e dizajnit industrial, dhe publikohet në buletin zyrtar të Zyrës, në mënyrën e paraparë me akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji.

## VENDIMI MBI SHPALLJEN E DIZAJNIT INDUSTRIAL NULË

### Neni 44

44.1. Procedurën për shpalljen e dizajnit industrial nulë e zbaton Zyra.

44.2. Zyra bën vendim për anulimin e dizajnit industrial nëse vërtetohet se nuk kanë ekzistuar kushtet për regjistrimin e dizajnit industrial të parashikuar sipas këtij Ligji.

44.3. Dizajni industrial mund të shpallet i nulë nga shkaqet e cekura në nenin 9. të këtij Ligji, edhe atë si gjatë gjithë kohës së mbrojtjes ashtu edhe pas ndërprerjes së vlefshmërisë së dizajnit industrial.

44.4. Dizajni industrial mund të shpallet pjesërisht nulë nga shkaqet e cekura në nenin 9. pikave b., e., f., dhe g. të këtij ligji, megjithëse me këtë shpallje të pjesshme të dizajnit industrial nulë i plotëson kushtet për regjistrim.

44.5. Për shkaqet e cekura në nenin 9. pika (c) të këtij neni mund të thirret vetëm personi i cili sipas dispozitave të këtij Ligji është i autorizuar për fitimin e dizajnit industrial.

44.6. Për shkaqet e cekura në nenin 9. pika (d) të këtij neni mund të thirret vetëm personi i cili sipas dispozitave të këtij ligji i është cenuar e drejta, paraqitësi i aplikacionit, Zyra sipas detyrës zyrtare dhe prokurori publik.

44.7. Për shkaqet e cekura në nenin 9. pika (e) dhe (f) të këtij ligji të thëret vetëm personi i cili sipas dispozitave të këtij ligji i është cenuar e drejta.

44.8. Kërkesën për shpalljen e dizajnit industrial nulë mund ta paraqes personi i autorizuar, prokurori publik dhe vet Zyra në bazë të detyrës zyrtare.

44.9. Kërkesa për anulimin e dizajnit industrial duhet të paraqitet sipas akteve tjera nënligjore për zbatimin e këtij Ligji.

44.10. Nëse dizajni industrial është anuluar, anulohen të gjitha pasojat juridike të dizajnit industrial.

44.11. Anulimi i dizajnit industrial regjistrohet në regjistrin e dizajneve industriale dhe publikohet në buletin zyrtar të Zyrës.

44.12. Shpallja e dizajnit industrial nulë regjistrohet në Regjistër dhe publikohet në buletin zyrtar të Zyrës.

KREU X  
DISPOZITAT E PËRBASHKËTA TË PROCEDURËS  
DISPOZITAT TJERA TË CILAT ZBATOHEN NË PROCEDURAT PARA ZYRËS

Neni 45

Për çështje të veçanta që lidhen me procedurën, dhe që nuk janë të rregulluara me këtë Ligj, do të aplikohet Ligji mbi procedurat e përgjithshme administrative.

TAKSAT DHE KOMPENSIMET E SHPENZIMEVE TË PROCEDURËS

Neni 46

46.1. Për procedurat e parapara me këtë Ligj paguhen taksat dhe pagesat e shpenzimeve të procedurës në pajtim me aktet tjera nënligjore në zbatim të këtij Ligji.

46.2. Nëse taksat ose pagesat e shpenzimeve të procedurës nuk janë paguar, aplikimi apo kërkesa refuzohet, kurse në rast të mos pagesës së shpenzimeve ose taksave për vazhdimin e mbrojtjes së dizajnit industrial, i njëjti pushon të vlejë.

CERTIFIKATA MBI TË DREJTËN E PËRPARËSISË

Neni 47

Me kërkesën e paraqitësit të aplikacionit për dizajn industrial apo bartësit të dizajnit industrial Zyra lëshon certifikatë mbi të drejtën e përparësisë.

REGJISTRAT

Neni 48

48.1. Zyra udhëheq Regjistrin e aplikacioneve dhe Regjistrin e dizajnëve industriale.

48.2. Regjistri i dizajnit industrial është publik, ndërsa të dhënat nga regjistri nuk i ekspozohen opinionit publik.

48.3. Zyra u lëshon personave të interesuar, pas pagesës së taksës dhe kompensimit të shpenzimeve, dokumente, ekstrakte dhe dokumentin e çregjistrimit nga regjistri i dizajnit industrial.

48.4. Të dhënat që regjistrohen në regjistra nga paragrafi 1. i këtij neni janë të përshkruara me akte tjera nënligjore në zbatim të këtij Ligji.

BULETINI ZYRTAR I ZYRËS

Neni 49

Zyra boton buletin zyrtar të Zyrës, në të cilën publikohen të gjitha të dhënat të parapara sipas këtij Ligji dhe me akte tjera nënligjore në zbatim të këtij Ligji.



## HULUMTIMI

### Neni 50

Me kërkesën e çdo personi të interesuar, zyra kryen shërbimet e hulumtimit të risive të dizajnëve industriale të regjistruara në Regjistrin e dizajnëve industriale që prodhojnë efekte në Kosovë.

## PËRFAQËSIMI

### Neni 51

Personat fizikë ose juridik të huaj që nuk kanë vendbanim ose seli të veprimtarisë në Kosovë mund t'i realizojnë të drejtat sipas këtij Ligji në procedurat para Zyrës vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të cilët janë të regjistruar në regjistrin e përfaqësuesve e udhëhequr nga Zyra.

## KREU XI

### DEPOZITIMI NDËRKOMBËTAR I DIZAJNIT INDUSTRIAL

### Neni 52

Depozitim ndërkombëtar i dizajnit industrial zbatohet në pajtim me dispozitat e marrëveshjes së Hagës për depozitim ndërkombëtar të dizajnit industrial. Në procedurën e njohjes së dizajnit industrial sipas dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Kosova është anëtare, aplikohen dispozitat e këtij Ligji në të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këto marrëveshje.

## KREU XII

### MBROJTJA CIVILO JURIDIKE

### PADIA KUNDËR SHKELJES SË DREJTËS

### Neni 53

53.1. Nëse bartësit të dizajnit industrial i janë cenuar ose shkelur të drejtat nga neni 17. i këtij Ligji, ai mund të kërkojë me anën e padisë nga gjykata e kompetente:

- a. vërtetimin e ekzistimit të cenimit të dizajnit industrial,
- b. ndalimin e shkeljes së kryer ose ndalimin e cenimit në kryerje e sipër të dizajnit industrial,
- c. eliminimin e gjendjes së krijuar me rastin e kryerjes së cenimit të dizajnit industrial duke përfshirë marrjen apo zhdukjen e lëndës me të cilën kryhet cenimi i dizajnit industrial,
- d. kompensimin e dëmit,
- e. publikimin e aktgjykimit me shpenzime të paditurit,
- f. përdorimin e lëndëve të marra.

53.2. Procedura në kuptim të paragrafi 1. të këtij ligji është urgjente.

53.3. Në procedurën e filluar për shkeljen e së drejtës nga dizajni industrial, paditësi mund të dëshmojë se dizajni industrial i regjistruar, në bazë të shkaqeve të cekura në nenin 9 të këtij ligji nuk është juridikisht i vlefshëm.

## VJETËRSIMI

### Neni 54

Padia për shkak të shkeljes të dizajnit industrial mund të paraqitet në afat prej tri vjetësh nga data e njoftimit për shkeljen dhe kryerësin dhe më së voni pesë vjet nga kryerja e shkeljes.

## MASAT E PËRKOHSHME

### Neni 55

55.1. Nëse bartësi i dizajnit industrial çmon se e drejta e tij është cenuar ose që ekziston rreziku për cenim të së drejtës së tij, nga gjykata mund të kërkojë:

- a. marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e kryerjes së veprimeve me të cilat shkelet apo cenohet e drejta e bartësit të dizajnit industrial,
- b. marrje të përkohshëm të lëndës kontestuese ose largimin e saj nga qarkullimi,
- c. masat për sigurimin e dëshmisë mbi lëndët nga pika paraprake dhe masat për ruajtjen e gjendjes ekzistuese.

55.2. Bartësi i dizajnit industrial mund të kërkojë marrjen-shqiptimin e masave të përkohshme edhe para se ta ngre padinë, me kusht që padinë ta bëjë në afat brenda 20 ditë pune ose 31 ditë kalendarike, varësisht prej asaj se cili afat është më i gjatë.

55.3. Nëse bartësi i dizajnit industrial nuk ngrit padi në afatin nga paragrafi 2 i këtij neni, me kërkesën e të paditurit gjyqi mund ta ndërpresë procedurën dhe të ndaloj masat e kërkuara.

55.4. Gjyqi mund të caktoj masa të përkohshme edhe pa dëgjimin e personit kundër të cilit është ngritë padia, në rastet kur mos marrja e masave të përkohshme do të rezultonte me shkaktimin e dëmeve për bartësin e dizajnit industrial.

55.5. Për çështjet që kanë të bëjnë me caktimin e masave të përkohshme të cilat nuk janë të parapara me këtë Ligj zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën përmbarese.

## KOMPENSIMI I DËMIT

### Neni 56

56.1. Gjykata mund t'i caktoj bartësit të dizajnit industrial kompensimin e dëmit nëse vërtetohet se masat e kërkuara në pajtim me nenin 55. paragrafi 1. janë të pa baza.

56.2. Gjykata mund t'i caktojë bartësit të dizajnit industrial një depozitë me shumë të caktuar të hollave me qëllim të sigurimit të personit kundër të cilit shqiptohet masa e përkohshme.

## NJOHJA GJYQËSORE DHE BARTJA E TË DREJTAVE

### Neni 57

57.1. Nëse aplikimin për dizajni industrial e ka bërë personi i paautorizuar ose dizajni industrial është regjistruar në Regjistrin në emër të personit të paautorizuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 12, të këtij Ligji, personi i autorizuar mund të bëjë kërkesë gjykatës për njohje ose për bartje të drejtave që i takojnë në tërësi ose pjesërisht, pavarësisht nga të drejtat tjera dhe kërkesave që dalin nga dizajni industrial.

57.2. Personat e autorizuar nga paragrafi 1. i këtij neni mund të iniciojnë procedurën gjyqësore në afat prej tri vitesh nga data e publikimit të aplikimit të dizajnit industrial, ndërsa në rast kur gjyqi vërteton që personi i paautorizuar nuk ka vepruar me qëllim të mirë, këtë procedurë mund të inicioj gjatë tërë kohës së zgjatjes së mbrojtjes së dizajnit industrial.

57.3. Nëse gjyqi sjell vendim të plotfuqishëm mbi njohjen dhe bartjen e së drejtës nga ky nen, e drejta e licencimit dhe të drejtat tjera të regjistruara në dobi të personave të tretë, pushojnë ditën e regjistrimit të ndryshimeve në Regjistër. Nëse para njohjes së të drejtës sipas këtij neni, personi i paautorizuar i së drejtës ose shfrytëzuesi i licencës kanë shfrytëzuar të drejtën ose kanë bërë përgatitje të mëdha për shfrytëzimin e së drejtës me qëllim të mirë, mund të fitojnë të drejtën e licencës së pashkëputshme në afat dhe nën kushtet e zakonshme të nevojshme për shfrytëzimin e së drejtave nëse këtë e kërkojnë në afat prej tre muaj nga dita e pranimit të njoftimit të cilin ua dërgon Zyra pas regjistrimit të pronarit të ri të së drejtës.

57.4. Zyra regjistron në Regjistër të dhënat e verifikuara nga vendimi i plotfuqishëm i gjykatës dhe ndryshimet tjera nga ky nen dhe do ti publikoj në buletin zyrtar të zyrës.

### KREU XIII DISPOZITAT KUNDËRVAJTSËSE

#### KUNDËRVAJTJET

##### Neni 58

58.1. Me dënim me mjete financiare prej 3.000 € deri 5.000 € do të dënohen për kundërvajtje personi juridik që krijon, ofron, vë në qarkullim, importon, eksporton ose përdorë produktin i cili përmban ose në të cilin është aplikuar dizajni i huaj industrial apo deponon një produkt të tillë për qëllime të sipër cekura.

58.2. Me dënim financiar prej 3.000 € deri 5.000 € do të dënohet për kundërvajtje personi juridik i cili e shfrytëzon licencën në kundërshtim me dispozita të kontratës për licencë apo nëse në mënyrë jashtë ligjore fitohet titulli i dizajnesit të dizajnit industrial.

58.3. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni do të dënohet personi fizik me gjobë prej 200 € deri 800 €

58.4. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. dhe 2. të këtij neni do të gjobitet personi përgjegjës në personin juridik prej 500 € deri 1.000 €

58.5. Produktet të cilat janë krijuar apo janë fituar me kryerjen e kundërvajtjeve nga paragrafi 1, 2, 3 dhe 4. të këtij neni, si dhe mjetet të cilat janë përdor për krijimin e produktit me të cilin shkelet dizajni industrial, do të mirën dhe do të asgjësohen pa marr parasysh se a janë në pronësi të kryesit.

KREU XIV  
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE  
PROCEDURAT NË VAZHDIM

Neni 59

59.1. Procedurat për njohjen e dizajnit industrial i cili deri në ditën e zbatimit të këtij ligji nuk kanë përfunduar do të vazhdoen me dispozitat të cilat kanë qenë në fuqi para fillimit të zbatimit të këtij Ligji.

59.2. Bartësi i modeleve dhe mostrës apo dizajnit industrial vlefshmëria e së cilës nuk është ndërprerë deri te dita e hyrjes në fuqi të këtij ligj, mund të kërkojë zgjatjen e mbrojtjes nën kushtet e njëjta dhe me të drejta të njëjta si edhe bartësi i të drejtës së dizajnit industrial në bazë të këtij Ligji.

59.3. Në rastet nga paragrafi 2 të këtij neni, Zyra modelet dhe mostrat apo dizajnin industrial vlefshmëria e të cilave zgjatet do të riemërohen dhe do të regjistrohen në regjistrin e dizajnit industrial dhe do të publikojnë vazhdimin e vlefshmërisë në buletin zyrtar të Zyrës.

59.4. Procedurat për shkeljen e të drejtave nga dizajni industrial apo nga shkelja e të drejtave nga aplikacioni dhe procedura për shpalljen e vendimit mbi njohjen e dizajnit industrial nulë të cilat nga dita e zbatimit të këtij ligji nuk kanë përfunduar, do të përfundojnë me dispozitat të cilat kanë qenë në fuqi nga dita e fillimit të zbatimit të këtij Ligji.

NDËRPRERJA E VLEFSHMËRISË TË LIGJEVE TJERA

Neni 60

Me datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji ndërpritet vlefshmëria e dispozitave të mëparshme që e kanë rregulluar këtë lëmi.

AKTE TJERA NËNLIGJORE PËR ZBATIMIN E KËTIJ LIGJI

Neni 61

Me akte tjera nënligjore në detaje rregullohen çështjet nga nenet 16. paragrafi 6, neni 25. paragrafi 4, neni 27. paragrafi 3, neni 35. paragrafi 2, neni 36. paragrafi 2, neni 37. paragrafi 2, neni 38. paragrafi 3, neni 39. paragrafi 10, neni 40. paragrafi 5, neni 48. paragrafi 4, neni 49, të këtij Ligji të cilat nxirren në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi, nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

HYRJA NË FUQI DHE ZBATIMI I KËTIJ LIGJI

Neni 62

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-45**  
**21 nëntor 2005**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**

**akademik Nexhat Daci**